



# BULETIN JAVOR

8-12 KORRIK 2024



## Zhvillohët Konferenca e Nivelit të Lartë e Sigurisë Kibernetike

U zhvillua në Tiranë Konferenca e Nivelit të Lartë e Sigurisë Kibernetike, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me mbështetjen e Bashkimit Europian. Me praninë e zëvendëskryeminstres, znj. Belinda Balluku, Shqipëria prezantoi arritjet dhe sfidat në fushën e sigurisë kibernetike.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi nevojën për bashkëpunim midis vendeve të rajonit për të sjellë praktikatat më të mira në luftën kundër sulmeve kibernetike, si dhe për përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në programet e mbështetjes së Bashkimit Europian në këtë fushë.

## Takimi Konsultues për Menaxhimin e Incidenteve të Sigurisë së Informacionit

AKSK zhvilloi një takim konsultues mbi metodologjinë për "Përcaktimin e procedurave për identifikimin, klasifikimin, përshkallëzimin dhe menaxhimin e krizës kibernetike".

Ky dokument synon të përcaktojë procedurat për identifikimin e një krize kibernetike, si dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga të gjithë aktorët kombëtarë për të menaxhuar një situatë të tillë.



## Konsultimi final për Metodologjinë Kombëtare të Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike prezantoi draftin final të Metodologjisë Kombëtare të Vlerësimit të Rrezikut të Sigurisë Kibernetike.

Kjo Metodologji është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike" dhe synon të sigurojë një kornizë gjithëpërfshirëse për identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe menaxhimin e rreziqeve kibernetike në infrastrukturatat kritike dhe të rëndësishme të informacionit dhe është në përputhje me Kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian (NIS2).



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II",  
Nr. 3, Kati I Tiranë



[www.aks.gov.al](http://www.aks.gov.al)



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039